



Buletini Mjedisor

MINISTRI KOKA INSPEKTON ZONËN PATOS-MARINZË



Ministri i Mjedisit Z. Lefter Koka zhvilloi ditën e mërkurë, datë 8 prill 2015, një vizitë në zonën Patos Marinzë për të parë nga afër situatën e krijuar pas shpërthimeve të gazit të disa ditëve më parë, i shoqëruar nga Kryeinspektori i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, z. Ergys Agasi.

Ministri i Mjedisit, inspektoi gjendjen aktuale mjedisore të prekur nga shpërthimet duke parë nga afër çdo objekt të prekur. Ministri Koka bisedoi me banorët të zones, të cilët i shprehën atij shqetësimet e tyre mbi ndotjen e mjedisit. “Situata është me të vërtetë shumë më keq dhe shumë më dramatike nga ajo që kemi parë nga ekranet e televizionit. I shpreh mirënjohjen time të thellë banorëve të zonës për mirëkuptimin e tyre. T’i dëmtosh kaq shumë dhe të gesh këtë lloj komunikimi njerëzor është një vlerë e këtij kombi dhe e kësaj Shqipërie” -tha Ministri Koka.- “Si Ministër Mjedisori dua t’ju garantoj se kemi bërë dhe do të bëjmë çdo gjë në respekt të ligjit, për t’u rikthyer banorëve të zonës, të gjitha dëmet e krijuara, por edhe për t’u krijuar një të ardhme të sigurtë në tokat e tyre”.

Duke iu referuar kompanisë “Bankers Petroleum”, Ministri Koka

vijoi: “Ky është një aktivitet privat, i cili sipas ligjit është kontraktuar për të shfrytëzuar burimet natyrore të këtij vendi, por kjo është një tokë e shtrenjtë shqiptare. Është një përgjegjësi shumë e madhe morale për t’u lënë fëmijëve tanë një tokë djerrë dhe jo një tokë të begatë.” Ministri Koka u shpreh se shumë shpejt qeveria shqiptare “do të bëjë që kompania të dëmshpërblejë 100 % banorët e prekur, si edhe të bëjë rehabilitimin e zonës. “Duhet të kuptoni miqtë e mi – vijoi më tej Ministri i Mjedisit- “që tetë vjet këtu është punuar në atë mënyrë që është punuar, duke mos u kontrolluar. Ne sot nuk jemi për t’u fshehur pas gishtit dhe për të thënë që të tjerët e krijuan situatën. Por jemi për të vënë në vend dinjitetin e banorëve të zonës dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre.” Më pas Ministri Koka është pyetur rreth laboratorit të lëvizshëm të monitorimit të ajrit të vendosur prej ditësh në vendin ku ndodhën shpërthimet. “Laboratori ka qenë në Fier, ku është Rafineria dhe rezultatet deri tani nuk janë pozitive, pasi sasia e squfurit është relativisht e lartë. Vazhdojmë të bëjmë prej disa ditësh matjet këtu

në burimin e ndotjes, ashtu siç kemi vepruar në qytete të Shqipërisë, që kanë nivel të lartë të ndotjes. Ju garantoj që këto rezultate janë të besueshme, pasi serveri i këtij laboratorit nuk ndodhet në vendin tonë, por jashtë tij dhe këto të dhëna sjellin një pasqyrë të qartë të situatës duke bërë të mundur transparencën”.

I pyetur nga mediat sesi mund të gjendet një zgjidhje për problemet e banorëve, Ministri Koka u përgjigj: “Ligji jep zgjidhje dhe është udhërrëfyes për çdo institucion shtetëror. Në shtator të vitit 2014, ne kemi filluar inspektimet në këtë zonë, në tetor kemi vendosur një masë administrative dhe në fund të shkurtit kemi kërkuar pezullimin e veprimtarisë duke njoftuar edhe institucionet përkatëse. Veprimet tona ligjore janë për t’u drejtuar Albpetrolit, si enti kontraktues me kompaninë “Bankers”. Nëse kompania nuk do të vendosë dhe nuk do të rikthejë zonën me afate të mirëcaktuara në një parametër optimal, ne do të kërkojmë largimin dhe prishjen e kontratës me kompaninë.

Më pas Ministri i Mjedisit vijoi inspektimin, duke kaluar në shtëpitë e prekura nga shpërthimet dhe duke bashkëbiseduar me banorët mbi situatën e krijuar.

MINISTRIA E MJEDISIT—KURUMI DUHET TË ZBATOJË LEGJISLACIONIN MJEDISOR

Inspektoriatit Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, pas një kontrolli disa-mujor vendosi të pezullojë veprimtarinë e shoqërisë “Kurum Internacional” Sh.a.

Gjatë inspektimit janë vërejtur disa shkelje të ligjeve të Mjedisit, si dhe të Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, sipas së cilit është

përcaktuar cikli i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve që krijohen nga aktivitetet të ndryshme.

Kryeinspektori Ergys Agasi shprehet se “Masa e pezullimit ndaj kompanisë do të ndërpritet vetëm pas plotësimit të të gjitha kërkesave ligjore nga ana e kompanisë, si dhe pas vlerësimit që do të bëhet nga

Ministria e Mjedisit, në përputhje me zbatueshmërinë e kërkesave ligjore, të cilat nuk janë respektuar nga kompania”.

Inspektoriatit, në përputhje me legjislacionin vendas, i ka vendosur këtij subjekti gjobën prej 1 milion lekë.

NË KËTË NUMËR:

MINISTRIA E MJEDISIT—KURUMI DUHET TË ZBATOJË LEGJISLACIONIN MJEDISOR FQ 1

22PRILL—DITA BOTËRORE E TOKES

LEJET MJEDISORE MARS 2015 – FQ 3-4

AKTIVITETET E MINISTRISË SË MJEDISIT NË MUAJIN MARS

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Përmbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitje dhe bashkëpunim veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime të mirëqënie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.

22 PRILL—DITA BOTËRORE E TOKËS



Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, zgjodhi pikërisht ditën e Tokës për të prezantuar, fillimin e punës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Tokës.

Ky aktivitet promovues u bë në qytetin e Librazhdit, pranë zonës së Mbrojtur të Shebenik-Jabllanicës. Ministri i Mjedisit, z. Koka, u shoqërua nga deputeti i qarkut të Elbasanit, z. Taulant Balla, si dhe nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, z. Zamir Dedej, e përfaqësues të tjerë.

Ministri Koka nisi fjalën e tij me apelin për qytetarët. “Sot është 22 prilli, Dita Ndërkombëtare e Tokës. Tema e këtij viti “Është radha jonë që të udhëheqim” do të thotë në vetvete që çdonjëri nga ne mund dhe duhet të kontribuojë me veprimet e tij për mbrojtjen e tokës. Toka ka qenë dhe është shumë bujare me të gjithë banorët e saj, por kemi qenë ne që e kemi dëmtuar rëndë atë.” Më tej Ministri i Mjedisit u shpreh se: “Kam kënaqësinë që të ndaj me qytetarët e Librazhdit fillimin e punës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, në krye të së cilës është z. Zamir Dedej, një ndër ambientalistët shqiptarë, që ka dhënë

kontributin e tij në vite. Janë caktuar tashmë edhe drejtorët rajonalë, si dhe 220 punonjës të kualifikuar, për të mundësuar që këto zona të mbrojtura t’i kthejmë sa më afër qytetarëve të konsideruara si vlera të shtuara të trojeve tona, të konsideruara si vlera të shtuara atraktive për turizimin, por edhe për ekonominë. Unë jam i bindur që përkushtimi i stafit do të jetë maksimal, por duhet të theksoj që maksimal duhet të jetë edhe përkushtimi i qytetarëve shqiptarë për të parandaluar dëmin në natyrë.”

Më tej, Ministri Koka theksoi se qeveria shqiptare ka rikthyer në qendër të vëmendjes politikat mjedisore. “Është rasti i parë, pas 25 vitesh që Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Mjedisit kanë mbjellë rreth 2.5 milionë fidanë që në vitin e parë dhe tashmë vjon nisma ambicioze për të mbjellë 10 milionë fidanë në katër vjet. Por kjo nuk mbaron këtu, pasi dëmet janë shumë të mëdha dhe rikuperimi nuk përfundon në një ditë. Kërkohej një punë shumë intensive për t’u lënë brezave të ardhshëm këtë tokë, ashtu siç do ta dëshironim”.

Në fjalën e tij deputeti Taulant Balla falenderoi Ministrin Koka për vëmendjen kushtuar mjedisit dhe posaçërisht Librazhdit, ku dhe ndodhet pjesa më e madhe e zonave të mbrojtura.

Ndërsa Drejtori i Agjencisë Kombëtare të

Zonave të Mbrojtura (AKZM) u shpreh se vizioni dhe qëllimi i AKZM-së është kthimi në identitetin e zonave të mbrojtura, sipas kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare dhe eksperiencës së vendeve europiane.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) krijon premisa për akses më të lehtë dhe vizibilitet të administratave të zonave të mbrojtura, duke mundësuar aplikimin e drejtpërdrejtë dhe menaxhimin direkt të fondëve nga ky institucion.

Nëpërmjet kësaj agencie synohet gjithashtu promovimi i vlerave turistike/rekreative, kulturore, gastronomike, estetike, pejsazhiste, shëndetësore, shpirtërore, etj., në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm me ndikim pozitiv të komuniteteve lokale dhe rritjes së mirëqënies së tyre.

AKZM u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave më 4 shkurt 2015, me propozim të Ministrisë së Mjedisit. Ky ishte një vendim mjaft i rëndësishëm për mjedisin shqiptar, sepse Zonat e Mbrojtura janë mbrojtëse dhe garantuese të botës së gjallë, por edhe burim ekzistence, të mirash materiale dhe të ardhurash për komunitetin.

Me krijimin e AKZM-së, Shqipëria i bashkohet edhe vendeve të tjera të Ballkanit, të cilat prej kohësh kanë struktura të tilla.

DËGJESAT E PUBLIKUT PËR AKTET LIGJORE QË HARTON MINISTRIA E MJEDISIT

Ministria e Mjedisit gjatë muajit Prill 2015 ka organizuar tre dëgjesa me publikun për aktet ligjore të hartuara nga kjo Ministri. Ky është një detyrim ligjor i Ministrisë së Mjedisit, që buron jo vetëm nga Konventa e Aarhusit, ratifikuar nga Qeveria shqiptare që në vitin 2000, por dhe nga legjislacioni kombëtar.

Është kthyer tashmë në traditë për Ministrinë e Mjedisit, realizimi i dëgjesave të publikut për aktet ligjore, si dhe programet dhe planet dhe strategjitë që harton kjo ministri.

Kështu, ditën e mërkurë datë 08.04.2015, në Ministrinë e Mjedisit u organizua dëgjesa me publikun për projektvendimin “Për procedurat dhe kërkesat e hollësishme për lidhjen e marrëveshjes vullnetare ndërmjet organizatave dhe grupeve, që përfaqësojnë interesa të caktuar, grupeve të operatorëve ose operatorëve individualë me autoritetet përkatëse, që të realizojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë, sesa ai i

përcaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përbërës mjedisor”.

Të pranishëm në këtë dëgjese ishin përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e mjedisit.

Ky draft-Vendim i Këshillit të Ministrave është hartuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji i Mjedisit, por jo vetëm kaq, ky draft vendim është një risi për Shqipërinë pasi mbështet dhe promovon lëvizjet pozitive të operatorëve të ndryshme apo shoqatave që në mënyrë vullnetare kërkojnë të zhvillojnë teknologjitë për mbrojtjen e një a më shumë përbërësve të Mjedisit në mënyrë vullnetare.

Drejtoria e Mjedisit u prezantoi të pranishmëve projektvendimin, procedurën, kërkesat e hol-

lësishme, rregullat dhe afatet për lidhjen e marrëveshjeve vullnetare, si një risi ku promovohen të gjithë organizatat dhe grupet, që përfaqësojnë interesa të caktuara grupet e operatorëve apo operatorët individualë, të cilët krijojnë apo lidhin marrëveshje me autoritetin përkatës, që është Ministria përgjegjëse për mjedisin. Më pas të pranishmit bënë pyetje dhe morën sqarimet e nevojshme në lidhje me këtë projekt-akt mjedisor, i cili tashmë do i kalojë dhe Ministrive të Linjës për komente.

Gjithashtu, gjatë këtij muaji u organizua dëgjesa e publikut “Për listën e detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative të rëndësishme në mjedis që do i nënshtrohen procesit të VSM-së” në datë 23.04.2015; si dhe dëgjesa “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, në datë 20.04.2015.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS PRILL 2015

NR.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	GREEN RECYCLING	VNM P Transportim, mbledhje, magazinim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme	Bathore, Kamëz, Tiranë	Refuzim
2	AGROTEK ALB	VNM TH Pulari	Arrameras, Fushë-Krujë, Durrës	Refuzim
3	A N A	VNM P Ndërtim godine industriale për prodhime farmaceutike	Xhafzotaj, Durrës	Refuzim
4	ANAKONDA PLUS	VNM P godinë polifunksionale, 2-3-4-15-16 kate, një kat nëntokë.	Vlorë	Vendimi Paraparak
5	KOMUNITETI MYSLIMAN SHQIPTAR	VNM P ndërtim Qendra Kulturore e Kuvajtit	Bajram Curri, Tropojë, Kukës	Vendimi Paraparak
6	AMERICAN FARM	VNM P Instalim për mbarëshitim blegtorie dhe përpunim i produkteve blegtorale	Yrshek, Kashar, Tiranë	Vendimi Paraparak
7	MP ENERGY	VNM TH Ndërtim shfrytëzim HEC-i	Komuna Leskovik, Kolonjë, Korçë	Deklaratë Mjedisore
8	VLLAZNIMI DEDA IMPORT EKSPORT	VNM P Fabrikë për pasurim mineral kromi dhe depozitim steril.	Surroj, Kukës	Refuzim
9	MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTEVE	VNM P Rikonstruksion i godinës së Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve	Tiranë	Vendimi Paraparak
10	GOLDEN EAGLE	VNM P Ndërtim shtesë sallash Rogner	Tiranë	Vendimi Paraparak
11	LLANAJ NDERTIM	VNM P Kompleks rezidencial	Vlorë	Vendimi Paraparak
12	ERA	VNM P Kapanon Industrial	Tiranë	Vendimi Paraparak
13	EUROELEKTRA	VNM P Kapanon Industrial	Tiranë	Vendimi Paraparak
14	EUROTEAM	VNM TH Grumbullim dhe magazinim i mbetjeve të rrezikshme	Tiranë	Deklaratë Mjedisore

NR.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	MARGIS ITALIA 1180	VP/ Resort Turistik	Tale, Lezhë	Shtyhet
2	MARGIS ITALIA 1182	VP/ Resort Turistik	Tale, Lezhë	Shtyhet
3	MARGIS ITALIA 1183	VP/ Resort Turistik	Tale, Lezhë	Shtyhet
4	MARGIS ITALIA 1186	VP/ Resort Turistik	Tale, Lezhë	Shtyhet
5	MARGIS ITALIA 1189	VP/ Resort Turistik	Tale, Lezhë	Shtyhet
6	MARGIS ITALIA 1219	VP/ Resort Turistik	Tale, Lezhë	Shtyhet
7	MALI 1284	VP/ Projekt nxjerrje mineral kromi	Objekti Sopot 1, Tropojë, Miniere nëntokësore	Refuzim VNM Paraprake
8	MALI 1285	VP/ Projekt nxjerrje mineral kromi	Objekti Rragami 2, Tropojë, Miniere nëntokësore	Refuzim VNM Paraprake
9	HP BIGAS dhe Veleshnjë ENENERGY	VP/ HEC, Bigas 1 dhe Bigas 2, përroi ujëmbledhës i Bigasit	Komuna Potom, Skrapar, Qarku Berat	Vendim VNM Paraprake
10	ENGJELL HOXHA	VP/ Depot e skrapit, përfshirë ato nga automjetet	Pranë fshatit Bardhas, në rrugën Elbasan - Peqin km 34	Vendim VNM Paraprake
11	AMAL	VP/ HEC-in Xhrë	Rrethi Librazhd, Komuna Hotolisht, Fshati Xhrë	Refuzim VNM Paraprake
12	A.L - ASFALT	VP/ Rikonstruksion, sistemim dhe asfaltim i rrugëve të brendëshme të fshatit Muçaj	Fshati Muçaj, Bashkia Vorë, Tiranë	Vendim VNM Paraprake
13	TIRANA BUSINESS PARK	vp/ Shpim pusi, ndërtim dhe funksionim impianti për trajtimin e ujit të pijshëm	Fushë Prezë, Komuna Prezë, Tiranë	Vendim VNM Paraprake
14	ALBITUMEN	VTH/ Instalime për përpunimin e naftës bruto dhe prodhimin e bitumit	Porto Romano, Katund i Ri, Durrës	Deklaratë Mjedisore

LEJET MJEDISORE MARS 2015

NR.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
1.	Kapaj	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga gurorët	Murtez	Miratim	Tipi B
2.	Rizai Company	Grumbullim, transportim, ruajtje, të mbejeve të ndryshme (skrap)	Rruga Korçë-Dishnicë, km 1	Refuzim	Tipi B
3.	V.A.L.E Recycling	III.2.B Grubullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim dhe asgjësim të mbejeve	Gurëz, Lezhë	Refuzim	Tipi B
4.	Alma Berberi	Prodhimi i alkoolit dhe pijeve alkoolike duke përfshirë fabrikat e birrës	Nartë, Vlorë	Refuzim	Tipi B
5.	Pellet Alba & Kadz	Kujdesja ose tretja kimike e lëndëve të drurit	Lagja "Skënderbeg" Shkodër	Miratim	Tipi B
6.	Dophil	Fabrikë për prodhim këpucësh	Xhafzotaj, Durrës	Miratim	Tipi B
7.	Adol	Prodhimi i alkoolit dhe pijeve	Kavajë	Miratim	Tipi B
8.	Jani Ciko	Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masa të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit	Rruga "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë	Refuzim	Tipi B
9.	Xhuliano-08	Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masa të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit	Objekt në zonën Novaj, Komuna Bogovë, Qarku Berat	Miratim	Tipi B

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME ITALINË NË FUSHËN E MONITORIMIT TË RADIOAKTIVITETIT



Në Ministrinë e Mjedisit u nënshkrua në muajin Prill Memorandumi i Bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të Shqipërisë dhe Instituti Italian të Fizikës Bërthamore (INFN) në fushën e monitorimit të radioaktivitetit.

Ky Memorandum hedh hapin e parë konkret drejt realizimit për herë të parë të një studimi të plotë mbarëkombëtar të shpërndarjes dhe identifikimit të shkallës së radioaktivitetit mjedisor në Shqipëri.

Në fjalën e tij Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, z. Julian Beqiri tha se: "Qëllimi i këtij bashkëpunimi është pikërisht monitorimi dhe evidentimi i plotë i radioaktivitetit mjedisor në Shqipëri, shkallës së përhapjes, dhe identifikimit të burimeve që shkaktojnë atë, si edhe efektet e të tij tek njeriu. Deri tani janë realizuar studime pjesore dhe jo gjithëpërfshirëse, sporadike dhe jo sistematike, si në kohë, ashtu edhe në frekuenca dhe në hapësirë. Duhet theksuar se këto monitorime të pjesshme dhe të painteguara nuk mund të përdoren për studime dhe analiza më të thella

e të plota. Ndërsa studimi që do të fillojmë do të bëhet në përputhje me praktikat më të mira europiane me qëllim përcaktimin e një kuadri rregullator dhe standarteve që do të bëjnë të mundur mbrojtjen e shëndetit të njeriut".

"Jam shumë i lumtur që ndodhem këtu dhe do të nënshkruaj këtë Memorandum Bashkëpunimi mes dy vendeve dhe institutive, që është një mundësi që nuk duhet humbur. Fillojmë një bashkëpunim në fushën e radioaktivitetit me Agjencinë Shqiptare, bashkëpunimi i cili mund të zgjerohet në të gjithë fushën kërkimore shkencore, duke e konsideruar si një hap më tej në bashkëpunimin që kemi pasur gjithmonë me Shqipërinë fqinje"- tha në fjalën e tij presidenti i INFN-së, z. Fernando Ferroni.

Duke përshëndetur nënshkrimin e Memorandumit, zv. Ministria e Mjedisit, znj Olijana Ifti, u shpreh se: "Monitorimi i mjedisit është një ndër prioritetet e politikave të mjedisit në vendin tonë. Aktualisht ne kemi një sistem të konsoliduar të monitorimit dhe të raportimit të gjendjes së mjedisit. Në bazë të rezultateve të monitorimit jepen njëkohësisht rekoman-

dime dhe adresohen masa të domosdoshme për minimizimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit.

Për këtë qëllim dua të vlerësoj maksimalisht nënshkrimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi midis këtyre dy institucioneve për forcimin e sistemit të monitorimit të ndotjes radioaktive ose nga rrezatimet".

Bashkëpunimi i vendosur nëpërmjet këtij Memorandumi do të shtrihet në pesë vite dhe në përfundim të këtij afati do të kemi për herë të parë një hartografim të plotë të nivelit të situatës së radioaktivitetit dhe të burimeve e aktiviteteve që e gjenerojnë atë, duke dhënë një panoramë të qartë dhe të plotë të tij, bazuar në metodologji tërësisht bashkëkohore kërkimore-shkencore.

Hartografimi i plotë ka një vlerë të jashtëzakonshme pasi edhe qasja e këtij studimi do të jetë lidhur ngushtë me efektet me karakter social-ekonomik dhe shëndetësor që ato kanë tek njeriu.



THËNIA E MUAJIT

**“ Mjedisi jonë, bota në të cilën jetojmë dhe punojmë,
është
pasqyra e qëndrimeve dhe pritshmërive tona.”**

Earl Nightingale

SEKTORI I TRANSPARENÇËS DHE KOMUNIKIMIT
Email: info@moe.gov.al

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE



**TË MENDOJMË
NDRYSHE**

Deri tani mentaliteti mbizotërues ka qënë që gjithmonë qytetarët janë në pritje të nismave që duhet të ndërmerren qeveria apo pushteti vendor për të përmirësuar mjedisin ku unë jetoj. Detyrimisht taksat paguhen që pushteti duhet të sigurojë një mjedis të përshatshëm për të jetuar, por sot duhet kuptuar që dhe ne vetë mund të bëjmë diçka për ta bërë të shëndtueshëm, të këndshme, për t'i dhënë më shumë shpresë vetes sonë.

Fotoja e parë është mundësuar nga një aktivitet i ndërmarrë nga disa shoqata rinore mjedisore që janë Eco Bicycle, Ecovolis dhe lëvizja vullnetare me postulatit “Të pastrojmë Shqipërinë”. Duhet që çdo njëri nga ne të bëjë pak për mjedisin dhe kjo mund të na bëjë të ndihemi më mirë në qytetin tonë të betonizuar tashmë.

Po jo vetëm në Tiranë ky grup rinor ka ndërmarrë inisiativa kaq të bukura dhe mbresëlënëse. Në qytetin e Rubikut, nën moton : “Të Pastrojmë Rubikun” një nga aktivitetet ishte parashikuar dhe rregullimi i parkut të shkollës së Rubikut me material të ricikluar. Për të mundësuar këtë inisiativë ndihmuar, jo vetëm vullnetarët, e lëvizjes “Të pastrojmë Shqipërinë”, por dhe nxënës, mësues e qytetarë të ndryshëm të qytetit të Rubikut.



**ORGANIZATAT MJEDISORE NË TAKIM
PËR NDRYSHIMET KLIMATERIKE**

ECRAN (Rrjeti për Aksesin Rajonal për Klimën dhe Mjedisin) synon asistimin e vendeve në transpozimin dhe zbatimin e politikave mjedisore dhe të klimës si një parakusht kryesor për aderimin në BE. Në dt. 23-24/04/2015 ECRAN organizoi një takim në Zagreb, me përfaqësues të organizatave mjedisore nga vende të ndryshme të rajonit dhe më gjerë si: Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria, Kosova, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Kroacia dhe Turqia. Organizatat shkëmbyen eksperiencat e tyre, në lidhje me fushatat dhe aktivitetet e realizuara në lidhje me problematikën e ndryshimeve klimatike dhe çështjeve të tjera mjedisore.



Takimi ofroi një pasqyrë gjithëpërfshirëse në praktikatat dhe politikatat e ndryshimeve klimatike të BE-së, si dhe evidentoi rolin dhe përgjegjësitë e aktorëve kyç. Ai kishte si qëllim përmirësimin e njohurive, know-how (të dish si) dhe aftësive të përfaqësuesve të shoqërisë civile në aspektet teknike të negociatave të ndryshimit të klimës, politikave kryesore dhe hapat që duhen ndjekur.



TRAJNOHEN SHOQATAT MJEDISORE

Në datat 15-16-17 prill, në kuadër të projektit ENV.NET të zbatuar në Shqipëri nga Co-Plan dhe të financuar nga BE, u

mbajt një trajnim i shoqatave mjedisore mbi aplikimin për fonde të BE-së, mbi legjislacionin evropian për mjedisin, për ndryshimet klimatike dhe energjinë e pastër.

Me aprovimin e statusit kandidat të Shqipërisë shumë fonde të BE-së të posaçme për Shqipërinë do të mbyllen. OJF-të shqiptare do të duhet të konkurrojnë me OJF-të e tjera të Europës për aksesin ndaj fondeve, prandaj përgatitja e tyre për ritjen e cilësisë së aplikimeve merr rëndësi të veçantë.

Gjithashtu gjatë trajnimit pjesëmarrësit mësuar mbi legjislacionin evropian për mjedisin, si dhe se cilat janë mekanizmat të cilët, me futjen e Shqipërisë në BE, do të sigurojnë zbatimin e tij. Kështu, organi kryesor i cili monitoron zbatimin e legjislacionit nga vendet anëtare është Komisioni Evropian. Me ardhjen e ankimeve për shkeljen e *acqui-së* nga ndonjë vend anëtar, ky komision fillon një hetim administrativ për mbledhjen e fakteve. Në vijim të hetimit, vendit anëtar i nisët një letër-vërejtje, e cila synon mbledhjen e fakteve të mëtejshme. Në përfundim të hetimit, nëse gjykon se çështja qëndron, Komisioni i drejtohet Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Në vitin 2012, 20% e shkeljeve të konstatuara, ose 272 shkelje, kanë qënë në fushën e mjedisit. Shoqatat mjedisore këtë mekanizëm do të mund ta përdorin për nxitjen e implementimit të *acqui-së* në Shqipëri.

Dita e tretë e trajnimit ju kushtua ndryshimeve klimatike dhe energjive të pastra. Në takim u prezantua kuadri ligjor i BE-së në këtë fushë, kuadri ligjor i Shqipërisë, si dhe ndryshimet mes tyre.

